## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

| Nr | Data e Kërkesës[1] | Objekti I Kërkesës[2] | Data e Përgjigjes[3] | Përgjigje[4] | Mënyra e përfundimit të kërkesës[5] | Tarifa[6] |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 29.08.2023 | Kërkesë për informacion për rregjistrim në programin e profesionistëve të mjekësisë | 01.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se ju duhet të aplikoni përmes portalit e-albania për të përfituar dokumentin që kërkoni. Bashkëlidhur gjeni linkun e aplikimit për deklaratën e pikëve: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13714 Për t'u rregjistruar në programin e certifikimit të profesionistëve, ju duhet të kryeni aplikimin online gjithashtu, nga llogaria e-albania. Bashkëlidhur gjeni linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14039 **Kujdes! Në rast se nuk keni llogari tuajën në portalin e-albania, ju duhet të krijoni llogarinë tuaj, që të mund të kryeni aplikimet e mësipërme!** Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, ose na kontaktoni ne live chat në faqen tonë zyrtare https://www.adisa.gov.al/ , që t'ju asistojmë më tej me procedurën. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 2 | 30.08.2023 | Kërkesë për informacion | 01.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se atëhere ju mund të kryeni një ankesë tek portali Me Ty Për | E plotë | Nuk ka |

[1] Data e regjistrimit të kërkesës
[2] Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[3] Data e kthimit të përgjigjes
[4] Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi
[5] Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar
[6] Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | për përftim të numrit të matrikullimit | | Shqiperinë Që Duam, për mosofrim të shërbimit brenda kohës së duhur. Bashkëlidhur linku: https://www.shqiperiaqeduam.al/ Gjithsesi, ju mund të kontaktoni edhe vet QSHA për të shpjeguar problematikën tuaj, në adresën agim.alia@qsha.gov.al . Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 3 | 30.08.3023 | Kërkesë për informacion për lidhje martese me shtetas të huaj | 01.09.2023 | Përshëndetje,Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj, nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet e mëposhtme për shpalljen e martesës (të legalizuar, përkthyer dhe noterizuar): Certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e Gjendjes Civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile; Dokumentin / Certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese);Dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj; Fotokopje e dokumentit të identifikimit. Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar. Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm:Certifikatë lindje; Certifikatë lindje me shënimin "për lidhje martese". Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare. Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikatë martese /ekstrakt akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e Gjendjes Civile në Shqipëri, në zyrën e Gjendjes Civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. **Lidhur me problematikën tuaj, ju mund të kryeni një prokurë të posacme ku autorizoni dike që jeton në Shqipëri që të** | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **kryej procedurat e shpalljes së martesës për ju dhe bashkëshortin tuaj të ardhshem. Per pyetje te tjera na kontaktoni ne live-chat online ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al/ .** | | |
| 4 | 01.09.2023 | Kërkesë për informacion për pension pleqërie | 01.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se: Personat e siguruar kanë të drejtë për pension pleqërie të reduktuar, deri tre vjet para mbushjes së moshës së daljes në pension të përcaktuar në nenin 92, kur: kanë plotësuar vitet e sigurimit, sipas nenit 92; nuk kryejnë veprimtari ekonomike si të punësuar, punëdhënës ose të vetëpunësuar. Pensioni i reduktuar është pjesë e pensionit të plotë dhe mbetet i reduktuar gjatë gjithë kohës së përfitimit. Ky pension llogaritet duke zbritur nga pensioni i plotë shumën që del nga shumëzimi i numrit të muajve të përfitimit të pensionit, para mbushjes së moshës së përcaktuar në nenin 92, me koeficientin mujor të reduktimit. Koeficienti i reduktimit të pensionit të plotë të pleqërisë, për personat që plotësojnë kushtet e parashikuara në paragrafin e parë, të këtij neni, është 0,6 për qind në muaj. Në vijim të informacionit të mësipërm, kur të mbushni moshën ligjore të pensionit, aplikohet në e-albania për shërbimin " Aplikim për pension pleqërie, suplementar pilot, suplementar lundrues i nëndetëseve apo suplementar për akademik", në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=6156 Pas aplikimit, dërgohen dokumentet me postë pranë Drejtorisë Lokale ose Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, duke vendosur mbi zarf numrin e referencës së aplikimit. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 5 | 01.09.2023 | Kërkesë për informacion për dërgim dokumentacion i | 01.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj ju bëjmë me dije se për të dërguar një dokument, duhet të logoheni me të dhënat tuaja në e-Albania dhe më pas të kërkoni shërbimin që keni aplikuar së fundmi, shërbim për të cilin do të dërgoni dokumentacionin. Pas kërkimit të shërbimit, duhet të klikoni **"Përdor"** dhe më pas do të vazhdoni në mes të faqes ku do të gjeni opsionin "Dërgoni dokument". Plotësoni të gjitha të dhënat e nevojshme dhe më pas klikoni " DËRGO". Për cdo pyetje ose paqartësi | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 6 | 31.08.2023 | Kërkesë për informacion për leje ndërtimi | 01.09.2023 | Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju duhet te paraqiteni prane Bashkise se qytetit ku jetoni dhe te interesoheni atje per proceduren qe do ndiqni. Ne rast se ju thone qe te beni aplikim online, do adresoheni tek linku i meposhtem per te aplikuar per leje ndertimi: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=6093. Nga ky link do zgjidhni llojin e lejes per te cilen do aplikoni ne baze te karakteristikave te baneses tuaj. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 7 | 31.08.2023 | Kërkesë për informacion për përfitim të ardhurash nga papunësia | 01.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju lutemi na kontaktoni në kanalin tonë online të chatit në faqen tonë zyrtare https://www.adisa.gov.al/ , që t'ju ndihmojmë drejtperdrejt me procedurën e aplikimit tuaj. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 8 | 01.09.2023 | Kërkesë për informacion për lidhje martese | 01.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se hapi i parë për lidhjen e martesës, është **shpallja e martesës.** Ju nuk e keni specifikuar nëse lidhja e martesës do të jetë me shtetas/e shqiptar/e apo me të huaj . Po Ju nisim procedurat për të dyja rastet; **- Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas shqipetar/e,** Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesa. Dokumentacioni i nevojshem per shpalljen e marteses midis dy shtetasve shqiptare ne republiken e Shqiperise eshte: certifikatë lindje, me shënimin "për shpallje martese"; fotokopje e dokumentit të identifikimit **dhe jo pasaporte** ; prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes; **-Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj,** | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet për shpalljen e martesës, të legalizuar, përkthyer, noteruar: certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e gjendjes civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile; dokumentin / certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese); dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj; fotokopje e dokumentit të identifikimit. Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILLE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noteruar. Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). **Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm: certifikatë lindje; certifikatë lindje me shënimin "për lidhje martese";** Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare. Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikate martese/ekstrakt akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e gjendjes civile në Shqipëri në zyrën e gjendjes civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin. **Shpallja e martesës online bëhet vetëm për shqiptarët rezidentë në Itali. Për të gjithë rastet e tjerë ndiqet procedura e mësipërme.** https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9781 Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit. | | |
| 9 | 04.09.2023 | Kërkesë për informacion për | 04.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se mandat pagesen mund ta paguani pranë sporteleve të postës shqiptare. Jepni komandën Dërgo, pajisuni me numrin e referencës së aplikimit, më pas shkoni tek opsioni "Dokumentet e mia" dhe shkarkoni | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pagesa per lëshim certifikatë pronësie | | mandatpagesën. Printojeni dhe paraqituni pranë postës për të bërë pagesën. Për cdo pyetje apo paqartësi na kontaktoni në kanalin informativ pa pagesë 0800 0118, ose online chat, nga e hëna në te premte ne fashen orare 08.00 – 19.00. | | |
| 10 | 04.09.2023 | Kërkesë për informacion për Transferimin nga gjimnazi në gjimnaz | 04.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se duhet të aplikoni nga llogaria e prindit në e-albania shërbimin: "Për cdo pyetje apo paqartësi na kontaktoni në kanalin informativ pa pagesë 0800 0118, ose online chat, nga e hëna në te premte ne fashen orare 08.00 – 19.00" duke ndjekur hapat e aplikimit.<br>Personi që ushtron përgjegjësin prindërore, identifikohet si qytetar në portalin e-Albania. -Zgjidhni shërbimin " Transferimi i nxënësve nga gjimnazi ne gjimnaz". -Klikoni butonin "Përdor". APLIKIM I RI:<br>-Plotësoni formularin e aplikimit dhe klikoni "Dërgo".<br>-Aplikimi i kalon për shqyrtim drejtorit të institucionit arsimor ku nxënësi kërkon te transferohet. -Drejtori i institucionit arsimor pritës shqyrton aplikimin dhe vendos aprovimin ose refuzimin e aplikimit për transferim te nxënësit. -Aplikuesi njoftohet elektronikisht për pranimin ose refuzimin e aplikimit te tij. -Ne rast aprovimi drejtori i IA-se dërguese nënshkruan dhe vulos dokumentacionin e transferimit, ia dorëzon nxënësit që do të transferohet, ia dërgon zyrtarisht drejtorit të IA-së pritëse dhe bën çregjistrimin e nxënësit. -Drejtori i IA-se pritëse bën regjistrimin e nxënësit. Pasi keni dhënë komandën DËRGO, pajiseni me numrin e aplikimit. Ky numër është numri i referencës që shërben për të gjurmuar aplikimin. Për cdo pyetje apo paqartësi na kontaktoni në kanalin informativ pa pagesë 0800 0118, ose online chat, nga e hëna në te premte ne fashen orare 08.00 – 19.00 | E plotë | Nuk ka |
| 11 | 04.09.2023 | Kërkesë për informacion për Certifikatë akti martesor | 04.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se shërbimi "Certifikatë nga akti i martesës" mundësohet online në portalin e-albania për aktet e regjistruara pas vitit 2010 . Për aktet e martesave të regjistruara para vitit 2010, do paraqiteni në zyrën e gjëndjes civile të arkivave pranë prefekturës së qarkut Tuaj. Kjo vlen për | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | të gjitha qarqet, përjashtuar qarku Tiranë. Për qarkun e Tiranës, procedohet si më poshtë vijon: Për Tirana qytet, do paraqiteni pranë Bashkisë Tiranë për të tërhequr certifikatat. Për fshatrat, do paraqiteni pranë Prefekturës së Qarkut Tiranë. Përjashtim bëjnë rastet kur martesa është lidhur jashtë kufijve të Shqipërisë. Këto certifikata edhe nëse martesa është lidhur jashtë veprohet njëlloj si në rastet kur martesa është lidhur para vitit 2010. Shqiptarët rezidentë jashtë kufijve, mund të aplikojnë nëpërmjet shërbimeve konsullore dhe shërbimin: "Aplikim për vërtetim certifikatë martese" është një shërbim elektronik, i cili u mundëson qytetarëve të aplikojnë online për të marrë më pas, nëpërmjet shërbimit postar, vërtetimin e certifikatës së martesës. Pas verifikimeve të nevojshme të kryera nga përfaqësues të ambasadës/konsullatës, pranohet aplikimi dhe aplikanti ftohet më pas të ndjekë procedurat për të kryer pagesën dhe për të dërguar mandatin origjinal (jo fotokopje) me postë. Kthimi i përgjigjes kryhet me e-mail tek qytetari dhe njoftohet gjithashtu për dërgimin e vërtetimit të certifikatës së martesës me postë në adresën e qytetarit. https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9486 Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 12 | 05.09.2023 | Kërkesë për informacion për certifikate pronesie | 06.09.2023 | Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Pershendetje, Kam certifikaten e pronesise se truallit por ne token time edhe te motres i eshte bere certifikata e prones se shtepise tezes. Si mund te veprojme ju lutem sepse ne certifikate e njejta truall figuron edhe ne emrin tim e te motres, edhe ne emrin e tezes (nje pjese e truallit tone) Tezja ka paguar ne ASHK Vore per pjesen tone te truallit (pjesen qe e kemi ne ne certifikate). Faleminderit. | E deleguar | Nuk ka |
| 13 | 05.09.2023 | Kërkesë për informacion | 06.09.2023 | Përshëndetje, Duke qene se kerkesa juaj për informacion është specifike, Ju lutemi na kontaktoni ne kanalin tone te komunikimit **live chat** ne | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | për lidhje martese me shtetas të huaj | | faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 për tju sqaruar hap pas hapi per rastin tuaj. Keshtu mund te kuptojme me mire rastin dhe t'ju ndihmojme ne kohe reale. Faleminderit. | | |
| 14 | 06.09.2023 | Kërkesë për informacion për aplikim per perfitim te statusit te jetimit | 06.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të përfituar statusin e jetimit duhet të aplikoni shërbimin, Aplikim për përfitim të statusit të jetimit, në linkun e mëposhtëm:https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14041 Nëse jeni përfitues i këtij statusi, për t`u pajisur me vërtetim paraqituni pranë zyrave të shërbimit social shtetëror, pranë bashkisë ose minibashkisë. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 15 | 06.09.2023 | Kërkesë për informacion për Rregjistrim të aktit të martesës | 06.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se lidhja e martesës bëhet veteëm me prezencën fizike të dy partnerëve në zyrën e gjendjes civile. Lidhja e martesës është një akt që nuk mund të bëhet me përfaqësues, pra me prokurë. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 16 | 06.09.2023 | Kërkesë për informacion për saktësim kufijve të pasurisë tokë | 06.09.2023 | Pershendetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të korrigjuar gabimet që referoni, duhet të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin " Saktësim i kufijve të pasurisë tokë", në linkun e mëposhtëm:https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13874 Ky aplikim shoqërohet me një kërkesë me shkrim nga i interesuari ku përfshihen të dhënat e nevojshme për identifikimin e pasurisë Për çdo pyetje apo paqartesi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0118, ose online chat, nga e hëna në të premte, në fashën orare 08.00 – 19.00. Faleminderit | E plotë | Nuk ka |
| 17 | 06.09.2023 | Kërkesë për informacion për | 06.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se per te bere ndarjen nga trungu familjar, do logoheni me te dhenat Tuaja ne e-albania dhe do te aplikoni sherbimin "Aplikim | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ndarje nga trungu familjar | | per ndryshim/Saktesim Vendbanimi" ne linkun e meposhtem: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14419 Ne aplikim do ngarkoni ne format PDF njerin nga dokumentet e meposhtme që vërtetojnë pronësinë e banesës ku do jetoni: **Kopje te noteruar te certifikates se pronesise**; **Kontrate noteriale qeraje; Akt noterial perdorimi banese**. Si edhe kartat e identitetit të secilit prej anëtarëve të familjes që do bëjnë shkëputjen bashkë me Ju. Fushat qe jane me * jane te detyrueshme per t`u plotesuar. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 18 | 06.09.2023 | Kërkesë për informacion për Legalizim i dokumentave | 06.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se çdo dokument që do përdoret jashtë kufijve të shtetit që e ka lëshuar, që të ketë fuqi ligjore, duhet të jetë patjetër i apostiluar. Ndërsa fotokopja e kartës së identitetit, nuk është e nevojshme të apostilohet.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 19 | 07.09.2023 | Kërkesë për informacion për aplikim per rregjistrim fillestar të personit fizik | 07.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se çdo person që do të ushtrojë aktivitet duhet të jetë pajisur paraprakisht me NIPT dhe të jetë i regjistruar në organet tatimore. Për të bërë kërkesën për NIPT, duhet të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania sherbimin, "Aplikim për regjistrimin fillestar të personit fizik" në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=4930 Para se të filloni aplikimin për regjistrim, duhet të pajiseni me nënshkrim elektronik duke aplikuar shërbimin, "Aplikim për pajisje me nënshkrim elektronik për të punësuarit dhe subjektet tatimpaguese" në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13521 Zgjidhni opsionin Administrator dhe cekoni se nënshkrimi është për regjistrimin fillestar të personit fizik. Menjëherë do pajiseni me nënshkrim provizor dyjavor pa pagesë. Punonjësi i QKB-së proceson kërkesën e ardhur dhe në varësi të vendimit që merret i kthen përgjigje | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | me e-mail aplikuesit. Subjektet, për qëllimet e regjistrimit fillestar, deklarojnë gjithashtu, të dhënat e detyrueshme, sipas legjislacionit tatimor, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të tilla si: xhiro vjetore, llojet e taksave për të cilat regjistrohet subjekti etj., si dhe atij të statistikave si Kodi i Nomenklaturës Ekonomike (NVE). Këto të dhëna plotësohen mbi bazën e vetëdeklarimit në seksionin "D" të formularit të aplikimit. Më shumë informacion mbi mënyrën e plotësimit të seksionit "D", do ta gjeni në faqen e internetit të QKB-së www.qkb.gov.al, në rubrikën "Regjistrimi", duke klikuar në linkun "Instruksione për regjistrimin tatimor". Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 20 | 07.09.2023 | Kërkesë për informacion për plotësim dokumentacion i për universitet | 07.09.2023 | Përshëndetje, Duke qene se kerkesa juaj për informacion është specifike, Ju lutemi na kontaktoni ne kanalin tone te komunikimit **live chat** ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 për tju sqaruar hap pas hapi per rastin tuaj. Keshtu mund te kuptojme me mire rastin dhe t'ju ndihmojme ne kohe reale. Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 21 | 07.09.2023 | Kërkesë për informacion për Portalin Me ty per Shqiperine qe Duam | 08.09.2023 | Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju bejme me dije se, për mosofrim të shërbimit në afatin ligjor të parashikuar, dërgoni ankesën Tuaj në portalin "Me ty për Shqipërinë që duam", në linkun e mëposhtëm: https://www.shqiperiaqeduam.al/#shtetiNeSHerbim<br>Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 22 | 07.09.2023 | Kërkesë për informacion për per moshen e pensionit | 08.09.2023 | Pershendetje, Ju lutemi na kontaktoni ne kanalin tone online **livechat** ne faqen tone zyrtare, ne menyre qe t'ju ndihmojme me kerkesen tuaj per informacion. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 23 | 08.09.2023 | Kërkesë për informacion | 08.09.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se orari zyrtar i IdentiTek është nga e hëna në të premte 08.00 deri 16.00. Për ditën e shtunë ka pasur njoftim zyrtar vetëm për ditën e shtunë | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | për passaporte biometrike | | datë 12 Gusht 2023. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 24 | 08.09.2023 | Kërkesë për informacion për Aplikim për njëvlefshmërinë e dëftesave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit | 11.09.2023 | Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju bejme me dije se ju duhet te aplikoni tek sherbimi : **Aplikim për njëvlefshmërinë e dëftesave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit. Linku i aplikimit: [https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14156](https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14156)** Shërbimi elektronik "Aplikim për njëvlefshmërinë e dëftesave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit" u vjen në ndihmë qytetarëve që aplikojnë për njëvlershmërinë e dëftesave të nxënësve të klasës I-XII të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit . Në këtë shërbim mund të aplikojnë për njehsimin e dëftesës, prindi i tij ose kujdestari ligjor, në të gjitha rastet kur nxënësi kthehet nga jashtë vendit në fillim ose në mes të vitit shkollor. **Dokumentacioni i nevojshëm: *Dokumente që ngarkohen nga aplikanti:* -**<br>**- Dokumenti i vijueshmërisë së klasës e përkthyer, noterizuar dhe vula apostile e shtetit nga vjen;**<br>**- Fotokopje e pasaportës dhe vulës hyrëse që pasqyron datën e rikthimit në atdhe të nxënësit. Hapat e procedurës**<br>- Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania; - Zgjidhni shërbimin “Aplikim për njëvlefshmërinë e dëftesave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit"; - Klikoni butonin "Përdor"; - Prindi dhe /ose kujdestari ligjor plotëson të gjithë të dhënat e nevojshme të kërkuara në formular dhe ngarkon dokumentacionin e kërkuar; - Klikoni butonin "Dërgo"; - Personi përgjegjës në ZVAP, kryen njehsimin e dëftesës së klasës sipas përcaktimeve të udhëzimit të MASR nr. 30, datë 29.12.2017 “ Për disa ndryshime në udhëzimin nr.44, datë 21.08.2013 “ Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”. ZVAP njofton zyrtarisht drejtorin e shkollës për klasën ku nxënësi do të regjistrohet dhe për | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | vlerësimet e konvertuara. - Aplikanti njoftohet me e-mail, në kohën që njehsimi ka përfunduar. **Koha e nevojshme e marrjes së shërbimit** Procedurat për njësimin e dëftesave, certifikatave kur dokumentacioni i kërkuar është i plotë, zgjasin deri në 10 ditë. **Periudha e vlefshmërisë** Pa afat **Kostot** Pa pagesë. **Ne vijim te pyetjes tuaj, duke ju referuar edhe informacionit te mesiperm, Po, juve ju duhet edhe vula apostile.** Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, ose ne livechat ne faqen tone zyrtare, https://www.adisa.gov.al/ . Faleminderit! | | |
| 25 | 08.09.2023 | Kërkesë për informacion për Dokumentacioni për njehsim diplome nga IAL | 11.09.2023 | Pershendetje, Ju lutemi na kontaktoni ne kanalin tone live chat qe te mund t'ju udhezojme lidhur me problematiken qe keni per dokumentacionin tuaj. Linku per adresen tone zyrtare: https://www.adisa.gov.al/ | E plotë | Nuk ka |
| 26 | 08.09.2023 | Kërkesë e paqartë për informacion | 11.09.2023 | Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju bejme me dije se, ju nuk keni specifikuar llojin e sherbimit per te cilin keni derguar dokumentat ne QSHA. Per rrjedhoje na duhet informacion specifik qw t'ju ndihmojme. Per kete arsye, ju lutemi na kontaktoni ne kanalin tone livechat ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al/ ne menyre qe t'ju ndihmojme me problematiken tuaj. | E plotë | Nuk ka |
| 27 | 09.09.2023 | Kërkesë për informacion për aplikim për verifikim online të gjendjes juridike të pronësisë. | 11.09.2023 | Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju lutemi na kontaktoni ne kanalin tone zyrtar live chat ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al/ ne menyre qe t'ju udhezojme per hapat e procedures se aplikimit, ose na kontaktoni ne numrin jeshil **0800 0118.** Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 28 | 11.09.2023 | Kërkesë për informacion për raportet e barrelindjes | 11.09.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se, pas kryerjes së aplikimit në e-albania, dhe dërgimit me postë të raportit mjekësor, kompetenca dhe përgjegjësia për pagesën e raporteve i kalon Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 29 | 11.09.2023 | Kërkesë për informacion për Lidhje martese | 11.09.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se hapi i parë për lidhjen e martesës, është **shpallja e martesës.**<br>Ju nuk e keni specifikuar nëse lidhja e martesës do të jetë me shtetas/e shqiptar/e apo me të huaj . Po Ju nisim procedurat për të dyja rastet;<br>**- Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas shqiptar/e,** Kërkesa për shpallje bëhet nga bashkëshortët e ardhshëm ose nga personi i caktuar nga ata me prokurë të posaçme. Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të përcaktojnë se në cilën zyrë të gjendjes civile do të lidhet martesa. Dokumentacioni i nevojshem per shpalljen e marteses midis dy shtetasve shqiptare ne republiken e Shqiperise eshte: ,certifikatë lindje, me shënimin “për shpallje martese”; fotokopje e dokumentit të identifikimit **dhe jo pasaporte** ; prokurë e posaçme, në rastet kur bashkëshortët e ardhshëm nuk janë prezent në procedurën e shpalljes;<br>**-Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj,**<br>Nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet për shpalljen e martesës, të legalizuar, përkthyer, noteruar:<br>1. certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e gjendjes civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile;<br>2. dokumentin / certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese);<br>3. dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj;<br>4. fotokopje e dokumentit të identifikimit; | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILLE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noteruar.<br>Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). **Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm:**<br>1. **certifikatë lindje;**<br>2. **certifikatë lindje me shënimin "për lidhje martese";**<br>Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare.Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikate martese/ekstrakt akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e gjendjes civile në Shqipëri në zyrën e gjendjes civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin.Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit. | | |
| 30 | 11.09.2023 | Kërkesë për informacion për Certifikate e gjendjes gjyqesore | 11.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se per te marre deshmine e penalitetit duhet te aplikoni nga llogaria Juaj ne e-albania sherbimin, Certifikatë e Gjendjes Gjyqësore (dëshmia e penalitetit)/ Judicial Records Certificate, në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13259<br>Dokumentin me vule elektronike e gjeni ne seksionin "Dokumentet e mia" ne llogarine Tuaj ne e-albania. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 31 | 11.09.2023 | Kërkesë për informacion për | 11.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion Ju bëjmë me dije se gjoba maturohet me kamatvonesa për faktin se nuk e keni paguar në kohë. Pasi është maturuar, është e detyrueshme të paguhet në total. Nuk mund të veçohet. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pagesën e gjobave | | pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalin e komunikimit (online chat); nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit | | |
| 32 | 11.09.2023 | Kërkesë e paplotë per informacion | 11.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se kërkesa juaj është e paplotë. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 33 | 11.09.2023 | Kërkesë për informacion për Kontributet e sigurimeve shoqerore | 11.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se derdhjen e kontributeve nga subjekti ku jeni e punësuar e gjeni duke aplikuar nga llogaria juaj në e-albania shërbimin,<br>Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore (pas datës 01.01.2012), në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13908<br>Fakti që figuroni të siguruar, por nuk keni marrë pagë, është paujdesi e financierit të subjektit që nuk u ka bërë shkëputjen në kohën e duhur. Gjithsesi ju und të aplikoni dhe vërtetim page për muajt e pretenduar. Aty vërtetohet nëse u ka kaluar pagë apo jo. Vërtetim page. https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14946<br>Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 34 | 12.09.2023 | Kërkesë e paplotë per informacion | 12.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se kërkesa juaj është e paplotë. Nuk keni referuar emrin e dokumentit që nuk mundeni të shkarkoni në mënyrë që ta përcillnim si problematikë. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 35 | 12.09.2023 | Kërkesë për informacion për Aplikim për njëvlefshmërin | 12.09.2023 | Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju bejme me dije se e afermja juaj duhet te aplikoj nepermjet portalit e-albania nga llogaria e saj peersonale per sherbimin: **Aplikim për njëvlefshmërinë e dëftesave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë** | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ë e dëftesave të nxënësve të arsimit parauniversitar | | **vendit. Bashkelidhur linku:** https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14156 **Dokumente që ngarkohen nga aplikanti:** - Dokumenti i vijueshmërisë së klasës e përkthyer, noterizuar dhe vula apostile e shtetit nga vjen; - Fotokopje e pasaportës dhe vulës hyrëse që pasqyron datën e rikthimit në atdhe të nxënësit. Kini parasysh se per te aplikuar ne nje dege universiteti, duhet diploma e njehesuar dhe plotesimi i formularit ne eAlbania: Bashkelidhur formulari: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=854 Ju bejme me dije se, Në zbatim të Urdhërit të Qendrës së Shërbimeve Arsimore, aplikimet/konfirmimet për "Matura Shtetërore 2023" për formularin A1Z për Kandidatët 2023, mund të kryhen nga data 31 gusht 2023, ora 08:00 deri në datën 1 shtator 2023, ora 16:00. Por sic e shikoni ka patur nje afat, megjithate do e kontrolloni here pas here se mund te hapen nje tjeter raund. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit. | | |
| 36 | 12.09.2023 | Kërkesë e paqartë për informacion | 12.09.2023 | Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju bejme me dije se QSHA nuk ofron nje sherbim specifik te tille per liste notash. Megjithate, mbase mund te keni ngaterruar emertimin e sherbimit qe po kerkoni, "Konvertim diplome". Per sherbimin konvertim/Njehsim i diplomave dhe certifikatave nga institucionet e IAL, ju bejme me dije se ju duhet te keni aplikuar tek linku bashkelidhur: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=853 . Sic e shihni edhe ne te dhenat e sherbimit, si me poshte thuhet se: **Koha e nevojshme e marrjes së shërbimit:** Procedura e njohjes dhe njësimit, pas aplikimit online, e kualifikimeve akademike që i përkasin nivelit 5 deri në 8, përveç gradave shkencore "Doktor", të Kornizës Shqiptare ose Evropiane të Kualifikimeve vijon me shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit nga ana e Komisionit të Njohjes së Diplomave në QSHA. Kjo procedurë, kur dosja e aplikimit është e plotësuar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas këtij udhëzimi, përfundon brenda 45 ditëve.Ne rast se i reheroheni ketij sherbimi, ju duhet te prisni 45 dite pune per te marre pergjigjen nga institucioni ne fjale. Ne rast se i | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | referoheni nje sherbimi tjeter, ju lutemi specifikoni llojin e sherbimit qarte per te cilin keni aplikuar, pasi "konvertim liste notash" nuk ekziston si sherbim ne portalin e-albania. | | |
| 37 | 13.09.2023 | Kërkesë për informacion për Passaporte biometrike | 13.09.2023 | Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju bejme me dije se, aplikimi per passaporte biometrike realizoht vetem atje ku individi eshte i rregjistruar ne gjendjen civile. Pra, nese nuk jeni te rregjistruar ne Tirane, Nuk mund te kryeni procedurat e aplikimit per passaporte ne qytetin e Tiranes. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 38 | 13.09.2023 | Kërkesë për informacion për Certifikate pronesie | 13.09.2023 | Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju bejme me dije se certifikatat e pronesise nuk leshohen nga institucioni i Bashkise, por nga Agjensia Shteterore e Kadastres. Ju lutemi na kontaktoni ne numrin jeshil falas 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. qe te mund t'ju ndihmojme me problematiken tuaj. Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 39 | 13.09.2023 | Kërkesë për informacion për Lidhje martese me shtetas te huaj | 13.09.2023 | Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju bejme me dije se hapi i pare per lidhjen e marteses eshte shpallja e marteses. Shpallja e martesës pa qenë i/e pranishëm kryhet me prokurë të posacme . Procedura për të bërë shpalljen e martesës është si më poshtë vijon: Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj, nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet e mëposhtme për shpalljen e martesës (të legalizuar, përkthyer dhe noterizuar):Certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e Gjendjes Civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile; Dokumentin / Certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore ne vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese); Dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj; Fotokopje e dokumentit të identifikimit. Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar. Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm: Certifikatë lindje;Certifikatë lindje me shënimin “për lidhje martese”. | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare. Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikatë martese /ekstrakt akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e Gjendjes Civile në Shqipëri, në zyrën e Gjendjes Civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Per pyetje te metejshme ju lutem na kontaktoni ne livechat ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al/ . | | |
| 40 | 13.09.2023 | Kërkesë për informacion për pagesa per njehsimin e diplomes | 14.09.2023 | Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Përshëndetje, Kam aplikuar për njohje të diplomës Bsc dhe Master. Jam nga Kosova. Ishte e pamundur me bë pagesën online.Nr e aplikacioneve janë: 1. MASR-2023-5512668-DY 2. MASR-2023-5058494-WH. Ju lutem më dërgoni një vegëz ose udhëzim për pagesë.Me respekt. | E deleguar | Nuk ka |
| 41 | 13.09.2023 | Kërkesë për informacion për Ankesë për moskthim përgjigje nga ASHK | 14.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion Ju bëjmë me dije se nëse pasuria është e dixhitalizuar pas konfirmimit të kryerjes së pagesës përgjigja do ju shfaqet tek *Dokumentet e mia* brenda 1 ditë pune, nëse jo, pas konfirmimit të pagesës dhe kryerjes së verifikimeve përgjigja do ju shfaqet tek *Dokumentet e mia* brenda 5 ditë pune. Për çdo ankesë lidhur me mosrespektimin e afatit ligjor të lëvrimit të shërbimit, lutemi depozitoni ankesën tuaj në portalin Me ty për Shqipërinë që duam në linkun e mëposhtëm. https://www.shqiperiaqeduam.al/#shtetiNeSHerbim Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalin e komunikimit (online chat); nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 42 | 14.09.2023 | Kërkesë për informacion për Ndryshimi i vendbanimit | 14.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të bërë ndryshimin e vendbanimit, do logoheni me të dhënat Tuaja në e-albania dhe do të aplikoni shërbimin "Aplikim për ndryshim/Saktësim Vendbanimi" në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14419 Në aplikim do ngarkoni në format PDF njërin nga dokumentet e mëposhtme që vërtetojnë pronësinë e banesës ku do jetoni: Kopje te noteruar te certifikates se pronesise; Kontrate noteriale qeraje; Akt noterial perdorimi banese. Është detyrim të ngarkoni dhe kartat e identitetit të secilit prej anëtarëve të familjes që do bëjnë shkëputjen bashkë me Ju. Të gjitha dokumentet do i ngarkoni në format PDF si një dokument i vetëm. **Shënim:Dokumenti i përdorimit të banesës është akt noterial që hartohet nga noteri në prani të dhënësit të ndërtesës në përdorim, dhe marrësit në përdorim.** Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 43 | 14.09.2023 | Kërkesë për informacion për vërtetim pensioni | 14.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se duhet të aplikoni nga llogaria juaj në e-albania shërbimin, "Vërtetim pensioni" në linkun e mëposhtëm. https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=5033 Shërbimi elektronik "Vërtetim pensioni" u mundëson qytetarëve të marrin online vërtetimin e përfitimit , mujor korent të pensionit me vulë elektronike me vlerë të plotë ligjore. Shërbimi është i vlefshëm vetëm për kategorinë e qytetarëve që përfitojnë pension. Vërtetimin e gjeneruar me vulë elektronike mund ta gjeni në çdo kohë në seksionin "Dokumentet e mia" te hapësira juaj në portalin e-Albania. Nëse u duhet vërtetim për një periudhë kohore të gjatë, aplikoni shërbimin "Vërtetim vjetor përfitimi afatgjatë" në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14988 Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 44 | 15.09.2023 | Kërkesë për informacion për testim i informatizuar pranë QSHA | 15.09.2023 | Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" neni 10, pika "d" përcakton se: "Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar". Pershendetje,si jeni? Desha tju pyes ne lidhje me testimin e informatizuar ne QSHA qe do te mbahet me 16 shtator per kandidatet nga trojet shqiptare Kosova, Presheva...Në çfare ore duhet te jemi prezent dhe a duhet te paguajm tarifen prej 5000 leke. Faleminderit per pergjigjen. | E deleguar | Nuk ka |
| 45 | 15.09.2023 | Kërkesë për informacion për leshim certifikatë pronësie | 15.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se institucioni kompetent për kthim përgjigje dhe pajisjen me certifikatë pronësie, është Agjencia Shtetërore e Kadastrës Drejtoria Lushnje. Nëse keni një përgjigje zyrtare ku ASHK u referon se nuk mund t`Jua mundësojë këtë dokument, mund të depozitoni ankesën Tuaj në portalin e bashkëqeverisjes në linkun e mëposhtëm: https://www.shqiperiaqeduam.al/#shtetiNeSHerbim. Gjithashtu mund të aplikoni informacion zyrtar lidhur me aplikimin e mëparshëm duke hartuar një kërkesë me shkrim ku të kërkoni informacion lidhur me çështjen Tuaj. Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë) https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477 Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 46 | 15.09.2023 | Kërkesë për informacion për leshim certifikatë pronësie | 15.09.2023 | Përshëndetje Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se institucioni kompetent për kthim përgjigje dhe pajisjen me certifikatë pronësie, është Agjencia Shtetërore e Kadastrës.Nëse keni një përgjigje zyrtare ku ASHK u referon se nuk mund t`Jua mundësojë këtë dokument, mund të depozitoni ankesën Tuaj në portalin e bashkëqeverisjes në linkun e mëposhtëm: https://www.shqiperiaqeduam.al/#shtetiNeSHerbim . Gjithashtu mund të aplikoni informacion zyrtar lidhur me aplikimin e mëparshëm duke | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | hartuar një kërkesë me shkrim ku të kërkoni informacion lidhur me çështjen Tuaj. Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë) https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477 Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit. | | |
| 47 | 15.09.2023 | Kërkesë për informacion për hipotekë objekti | 15.09.2023 | Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Pershendetje Kam prenotuar nje apartament tek kompania "Kontakt.al" - Kompleksi "Mangalen" ne rrugen "Ali Demi" (pallati 38, hyrja 2938, 59 m2 1+1, kati 2) qe ne janar 2023 dhe punonjes te firmes me thone qe dokumentat per aplikim per hipoteken e apartamentit jane derguar ne fund te qershorit 2023 dhe jemi ne pritje nga institucionet perkatese per ngarkimin e tyre ne sistem. Kete nuk e kuptoj. Nderkohe une dua te di nese keto dokumente kane ardhur tek ju per aplikim? Per sa kohe pas aplikimit, del hipoteka e apartamentit tim?Faleminderit! | E deleguar | Nuk ka |
| 48 | 18.09.2023 | Kërkesë për informacion informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë | 18.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të marrë informacion për çështjen që referoni në kërkesën për informacion, aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin: Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë), ne linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477 Fillimisht duhet të hartoni një kërkesë me shkrim, ku të sqaroni arsyet e përdorimit të këtij dokumenti . Kjo kërkesë duhet të firmoset nga ana Juaj dhe të skanohet në formatin PDF . Kërkesa do të ngarkohet në hapin e tretë të aplikimit të shërbimit në e-Albania. Për të përdorur shërbimin, klikoni “Përdor” në fund të faqes dhe vijoni me plotësimin e formularit elekronik. Pavarësisht se keni apo nuk keni të dhëna prone, për të orientuar sistemin duhet të vendosni një zonë të saktë kadastrale, ndërsa | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | volumin dhe faqen i vendosni 1, 9 ose 99. Zona kadastrale duhet të jetë zona që përfshin zonën ku ndodhet vendndodhja Juaj. Klikoni butonin "Dërgo" në faqen e fundit të formularit. Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë ose në postë për të kryer pagesën, si dhe depozitimin me postë të kërkesës që keni bashkëlidhur aplikimit dhe mandatin e pagesës që do të kryeni. Agjencia Shtetërore e Kadastrës do T`Ju pajisë me informacionin që kërkoni.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 49 | 18.09.2023 | Kërkesë për informacion për Akt Verifikimi | 18.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të plotësuar një AV, ose e quajtur ndryshe "Akt Verifikimi" duhet të logoheni me të dhënat tuaja në e-Albania dhe më pas të kërkoni shërbimin që keni aplikuar së fundmi. Pra shërbim për të cilin do të plotësoni dokumentacionin me AV. Pas kërkimit të shërbimit duhet të klikoni **"Përdor"** dhe më pas do të vazhdoni në fund të faqes ku do të gjeni opsionin, Për të plotësuar AV të një aplikimi të mëparshëm. Pasi të plotësoni të dhënat korrekt sipas shkresës ku ASHK u ka kërkuar të plotësoni AV, klikoni butonin **"Dërgo".** Ky dokument (AV) është kërkesa ose shkresa juaj që do ia drejtoni ASHK-së. Për çdo pyetje apo paqartësi, na kontaktoni në kanalin informativ pa pagese 0800 0118, nga e hëna në të premte në fashën orare, 08.00 – 19.00. Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 50 | 18.09.2023 | Kërkesë për informacion për ndryshim/ Saktësim Vendbanimi | 18.09.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të bërë ndryshimin e vendbanimit, do logoheni me të dhënat Tuaja në e-albania dhe do të aplikoni shërbimin "Aplikim për ndryshim/Saktësim Vendbanimi" në linkun e mëposhtëm:https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14419<br>Në aplikim do ngarkoni në format PDF njërin nga dokumentet e mëposhtme që vërtetojnë pronësinë e banesës ku do jetoni:<br>Kopje te noteruar te certifikates se pronesise,kontrate noteriale qeraje Akt noterial perdorimi banese, Si edhe kartat e identitetit të secilit prej anëtarëve të familjes që do bëjnë ndryshimin bashkë me Ju. **Dokumenti i përdorimit të banesës është akt noterial që hartohet nga noteri në prani të dhënësit të ndërtesës në përdorim, dhe marrësit në** | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **përdorim.** Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 51 | 18.09.2023 | Kërkesë për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë) | 18.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të marrë informacion për çështjen që referoni në kërkesën për informacion, aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin: Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë), në linkun e mëposhtëm: **https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477** **Fillimisht duhet të hartoni një kërkesë me shkrim, ku të sqaroni arsyet e përdorimit të këtij dokumenti . Kjo kërkesë duhet të firmoset nga ana Juaj dhe të skanohet në formatin PDF . Kërkesa do të ngarkohet në hapin e tretë të aplikimit të shërbimit në e-Albania.Për të përdorur shërbimin, klikoni "Përdor" në fund të faqes dhe vijoni me plotësimin e formularit elekronik.**Pavarësisht se keni apo nuk keni të dhëna prone, për të orientuar sistemin duhet të vendosni një zonë të saktë kadastrale, ndërsa volumin dhe faqen i vendosni 1, 9 ose 99. Zona kadastrale duhet të jetë zona që përfshin zonën ku ndodhet vendndodhja Juaj. Klikoni butonin "Dërgo" në faqen e fundit të formularit.Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë ose në postë për të kryer pagesën, si dhe depozitimin me postë të kërkesës që keni bashkëlidhur aplikimit dhe mandatin e pagesës që do të kryeni.Agjencia Shtetërore e Kadastrës do T`Ju pajisë me informacionin që kërkoni.Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 52 | 18.09.2023 | Kërkesë për informacion për pasaportë biometrike | 18.09.2023 | Përshëndetje,Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion ,Ju bëjmë me dije se, si pajisja për herë, si rinovimi i pasaportës, bëhen vetëm në qytetin ku figuroni e regjistruar në regjistrin kombëtar të popullsisë. Pra, nuk mund ta rinovoni në qytetin e Tiranës. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 53 | 18.09.2023 | Kërkesë e paplotë për informacion | 18.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se kërkesa është e paplotë. Nuk keni referuar nëse jeni subjekt tatimor, pra që keni një NIPT dhe një kod NVE, që përcakton fushën për të cilën operon biznesi Juaj aktualisht. Gjithsesi, edhe nëse e keni një të tillë, duhet patjetër të pajiseni me licencë profesionale e cila miraton përdorimin e këtyre pajisjeve nga një profesionist i licensuar në fushën e shëndtësisë. Aplikimi i dërgohet Qendrës Kombëtare të biznesit, ndaj, për detaje, kontaktoni kujdesin e klientit të Qendrës Kombëtare të Biznesit në numrin 042250066. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 54 | 19.09.2023 | Kërkesë për informacion për Lëshim Vërtetimesh Negativ/Pozitiv | 19.09.2023 | Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se vërtetimi duhet për çdo pjestar të familjes. Antarët madhorë të familjes e kanë të mundur të aplikojnë nga llogaria e tyre në e-albania shërbimin Lëshim Vërtetimesh Negativ/Pozitiv, në linkun e mëposhtëm:https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9464 Ndërsa fëmija nën 16 vjeç nuk e ka të mundur. Për të marrë vërtetim për fëmijën e mitur, aplikoni nga llogaria e prindit në e-albania shërbimin:Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë), ne linkun e mëposhtëm: **https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477** Procedura duhet të shoqërohet me një kërkesë me shkrim nga ana Juaj, te cilen do ta ngarkoni në format PDF në hapin e tretë të aplikimit. Agjencia Shtetërore e Kadastrës do T`Ju pajisë me informacionin që kërkoni.Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 55 | 19.09.2023 | Kërkesë për informacion për pajisje me passaportë biometrike | 19.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion ,Ju bëjmë me dije se, si pajisja për herë, si rinovimi i pasaportës, bëhen vetëm në qytetin ku figuroni i regjistruar në regjistrin kombëtar të popullsisë. Pra, nuk mund të aplikoni në asnjë qytet tjetër. Lidhur me pyetjen se në cilën zyrë ADISA duhet të paraqitet, Ju informojmë se qytetarja duhet të paraqitet në zyrat e IdentiTek( ish zyrat Aleat) në qytetin e Skraparit. Më poshtë gjeni dhe informacionin e detajuar se si aplikohet për pasaportë | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | biometrike. Për të kryer aplikimin për pajisje me Pasaportë Biometrike për herë të parë ose kur pasaporta juaj aktuale është lëshuar para datës **31 Dhjetor 2011**, nevojitet të plotësoni online në portalin e-Albania formularin e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, duke klikuar linkun:https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13851 Klikoni opsionin "Përdor" dhe plotësoni formularin "Aplikim i formularit për lëshim për herë të parë ose rinovim të pasaportës". Ju nevojitet ngarkimi i fotografisë në standardin 4x5cm në formatin jpg, jpeg ose png.Në rastin kur aplikimi është me procedurë të përshpejtuar (ose aplikim emergjent), nevojitet përveç ngarkimit të fotos, edhe ngarkimi i kopjes së kuponit të procedurës së përshpejtuar. Pas shqyrtimit të aplikimit do të njoftoheni me sms dhe e-mail brenda 7 ditëve për miratimin ose jo të procedurës ligjore të kërkuar nga Policia. Ditën që do të paraqiteni fizikisht për të vijuar me aplikimin, duhet të keni me vete kuponin dhe pasaportën aktuale që do të duhet ta dorëzoni pranë Zyrës së ALEAT. **Kujdes!** Emaili me të cilin jeni i regjistruar në e-albania duhet të jetë aktiv sepse atje do Ju vijë miratimi i aplikimit **Gjithashtu, Ju mund te gjurmoni statusin e aplikimit nëpërmjet numrit të referencës së aplikimit.** Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 56 | 19.09.2023 | Kërkesë për informacion për vërtetim kontributesh | 21.09.2023 | Pershendetje,  Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju lutemi na kontaktoni ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al/ ne live-chat online , ne menyre qe t'ju ndihmojme drejtperdrejt per problematiken tuaj. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 57 | 19.09.2023 | Kërkesë për informacion për njehsim diplome nga IAL | 21.09.2023 | Përshendetje i nderuar, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" neni 10, pika "d" përcakton se: "Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar". Përshendetje e nderuar po ju shkruaj nga Kosova,dua ta bej njehsimin e diplomes bsc dhe msc mirepo pagesa | E deleguar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | e tarifes arketuese nuk po mundem ta kryej ne Kosove. Per arsye se ne Fakture te Qsha nuk shkruan informata ku mund ta kryej pagesen ne Kosove. Numri i llogarise bankare, Iban, Swift code. A mund te mi tregoni keto ,shendet. | | |
| 58 | 19.09.2023 | Kërkesë për informacion për lidhje martese me shtetas te huaj | 21.09.2023 | Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju bejme me dije se, Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj, Nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet për shpalljen e martesës, të legalizuar, përkthyer, noteruar: 1. certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e gjendjes civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile; 2. dokumentin / certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese); 3. dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj; 4. fotokopje e dokumentit të identifikimit; Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILLE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noteruar. Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm: 1. certifikatë lindje; 2. certifikatë lindje me shënimin "për lidhje martese"; Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare. Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikate martese/ekstrakt akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e gjendjes civile në Shqipëri në zyrën e gjendjes civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin. Ne vemendjen tuaj sjellim: Bashkeshorti i ardhshem shtetas i huaj nese nuk paraqitet dot vet per shpalljen e marteses mund te autorizoj ju ose dike qe te dorezoj dokumentat per te nepermjet nje prokure. Kurse per kryerjene celebrimit | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | duhet te jete patjeter vet prezent. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 59 | 20.09.2023 | Kërkesë për informacion për provimin e shtetit | 21.09.2023 | Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju lutemi na kontaktoni ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al/. | E plotë | Nuk ka |
| 60 | 20.09.2023 | Kërkesë për informacion për certifikatë pronësie | 21.09.2023 | Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju lutemi na kontaktoni ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al/ ne live-chat online ose na kontaktoni ne numrin pa pagese 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, ne menyre qe t'ju ndihmojme drejtperdrejt per rastin tuaj. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 61 | 21.09.2023 | Kërkesë për informacion për Aplikim për regjistrimin përfundimtar të ndërtimeve të reja | 21.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjme me dije se fillimisht duhet te interesoheni prane Bashkise per tu pajisur me Certifikate Perodrimi ,si dhe te komunikoni qe jeni per objektet e ndertuara per shkak te termetit.Pasi te pajiseni me Certifikate Perdorimit ju duhet te aplikoni nepermjet portalit E-albania për regjistrimin e saj dhe per t`u pajisur me certifikatë pronësie duhet të aplikoni shërbimin, Aplikim për regjistrimin përfundimtar të ndërtimeve të reja , në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9455 Në hapin e dytë duhet të shtoni edhe këto shërbime: L1- Lëshim certifikate pronësie; I5- Lëshim kopje kartele te pasurisë; I4- Lëshim kopje te fragmentit te hartës kadastrale. *Dokumente që ngarkohen nga aplikanti:* - Leje ndërtimi e dhënë nga organi kompetent i periudhës kur është bërë ndërtimi ; - Shkresë përcjellëse nga institucioni që ka lëshuar aktin.Dokumentacioni i nevojshëm për t`u ngarkuar jane dokumentat e sipercituar te cilat duhet të ngarkohen në të gjitha rubrikat e detyrueshme në hapin e tretë ne formatin PDF. Në hapin e tretë, si datë lëshimi të dokumentit do të vendosni datën e Vendimit . Në fund klikoni opsionin “Dërgo”. Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në Poste për të kryer pagesën dhe postimin e dokumentacionit origjinal duke i bashkelidhur siper aplikimit dhe | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | mandatin e paguar. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, ose në online chat, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit. | | |
| 62 | 22.09.2023 | Kërkesë për informacion për Regjistrimi i Aktit të Lindjes | 22.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se regjistrimi i aktit të lindjes nuk mundësohet online në e-albania. Për të bërë regjistrimin e fëmijës do paraqiteni pranë Njësisë Administrative ku janë të regjistruar prindërit e fëmijës duke pasur me vete Aktin e asistencës së lindjes nga spitali, dhe dy letërnjoftimet elektronike të prindërve (kartat e identitetit) brenda afatit të vlefshmërisë. Që ta regjistroni në qytetin e Tiranës, fillimisht duhet të bëni ndryshimin e vendbanimit. Për të bërë ndryshimin e vendbanimit, do logoheni me të dhënat Tuaja në e-albania dhe do të aplikoni shërbimin "Aplikim për ndryshim/Saktësim Vendbanimi" në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14419 Në aplikim do ngarkoni në format PDF njërin nga dokumentet e mëposhtme që vërtetojnë pronësinë e banesës ku do jetoni: Kopje të noteruar të certifikatës së pronësise. Kontratë noteriale qeraje, Akt noterial përdorimi banese, Si edhe kartat e identitetit të secilit prej anëtarëve të familjes që do bëjnë shkëputjen bashkë me Ju. Fushat që janë me * janë të detyrueshme për t`u plotësuar. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 63 | 23.09.2023 | Kërkesë për informacion për kontakt ADISA | 25.09.2023 | Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju bejme me dije se numri jeshil per te kontaktuar shkruhet pa prefiks. Ky eshte numri jeshil 0800 0118 . Lutemi na kontaktoni ne kete numer. Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 64 | 23.09.2023 | Kërkesë për informacion për njehsim diplome nga IAL | 26.09.2023 | Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Pershendetje, Kam aplikuar per njohje te | E deleguar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | diplomes ne QSHA. Vertetimin e kam pranuar te bashkangjitur ne email nga E-Albania dhe pervec tjerash shkruante "Ju mund te shkarkoni pergjigjen elektronike te institucionit, ne portalin e-Albania te rubrika "Dokumentet e mia". Pasi qe jam nga Kosova, nuk mund te regjistrohem ne e-Albania dhe si pasoje nuk mund te kem qasje ne rubriken "Dokumentet e mia". Shqetesimi im eshte se a do te njihet vetem ai dokument ne Universitet apo duhet te regjistrohem gjithsesi ne E-Albania?! A mund te me ndihmoni me kete ceshje, ju lutem? A ka dicka tjeter pervec vertetimi qe m'a kane dergu ne ate rubrike, apo vetem ajo? Nese jo, po e marr vertetimin nga email-i per aplikim.Falemnderit paraprakisht! Gjitha te mirat. | | |
| 65 | 23.09.2023 | Kërkesë për informacion për bonusin e bebes | 26.09.2023 | Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju mund te perfitoni bonusin e bebes sipas hapave te meposhtme: Prindërit e fëmijës së porsalindur (të celebruar/pa celebruar) paraqiten pranë sportelit të dedikuar dhe paraqesin këto dokumente: Kartën e identitetit të dy prindërve; Certifikatën e Aktit të lindjes. Nëpunësi i gjendjes civile bën fotokopje të Kartës së Identitetit dhe krye, veprimet e verifikimit online të statusit të nënës për të bërë regjistrimin e fëmijës së porsalindur në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC) të vitit 2010. Nëpunësi i gjendjes civile plotëson të dhënat për fëmijën e porsalindur në sistemin e gjendjes civile, duke vendosur të dhënat mbi emrin e fëmijës, mbiemrin që do të mbajë (në rast se nuk ka kundërshtime, të babait), datën, orën, vendin e lindjes, peshën, si dhe adresën e banimit. Në rast se prindërit nuk janë të celebruar, vendoset adresa e nënës. Gjithashtu, në këtë formë plotësimi, hidhen edhe të dhëna për efekt statistikor për INSTAT. Informacion që plotësohet për INSTAT: (a) vendi i lindjes, (b) pesha e fëmijës, (c) vitet e martesës, (d) Radha e lindjes (për nënën).Nëpunësi printon Certifikatën e Aktit të lindjes, me emrin e fëmijës, e cila nënshkruhet nga prindërit dhe nëpunësi, si dhe vendoset vula përkatëse, si dhe Certifikatën e Lindjes së fëmijës, në dy kopje, një për prindërit dhe një për dosjen e nëpunësit. Pas regjistrimit, nëpunësi kryen verifikimet e nevojshme për përcaktimin e masës së ndihmës së menjëhershme financiare (bonusi). Ndihma e menjëhershme financiare | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | (bonusi) i jepet nënës, menjëherë pas marrjes së Certifikatës së Asistencës në Lindje, në formën e një çeku, të emetuar në emër të nënës dhe të pagueshëm: 35 (tridhjetë e pesë mijë) lekë menjëherë pas lëshimit nga institucionet e shërbimit spitalor të dokumentit "certifikatë asistence në lindje"; 75 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë menjëherë pas lëshimit nga institucionet e shërbimit spitalor të dokumentit "certifikatë asistence në lindje"; 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë menjëherë pas lëshimit nga institucionet e shërbimit spitalor të dokumentit "certifikatë asistence në lindje"; 6. Diferenca e mbetur prej 5 (pesë mijë) lekësh, sipas pikës 6, përfitohet pas përfundimit të procedurave të regjistrimit të fëmijës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.<br>Në rastet kur fëmija lind në maternitetet publike dhe prindërit nuk kanë përcaktuar emri, diferenca e mbetur prej 5 (pesë mijë) lekësh, sipas pikës 6, përfitohet pas përfundimit të procedurave të regjistrimit të fëmijës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. 7. Me qëllim përftimin e bonusit, nëpunësi i gjendjes civile pajis prindërit me 2 (dy) certifikata, përkatësisht: Certifikatë familjare dhe Certifikatë lindje, me shënimin "Për bonusin e lindjes". 8. Në përfundim, prindi pajiset me këto dokumente: Diferenca e mbetur prej 5 (pesë mijë) lekësh, sipas pikës 6, përfitohet pas përfundimit të procedurave të regjistrimit të fëmijës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.Në rastet kur fëmija lind në maternitetet publike dhe prindërit nuk kanë përcaktuar emri, diferenca e mbetur prej 5 (pesë mijë) lekësh, sipas pikës 6, përfitohet pas përfundimit të procedurave të regjistrimit të fëmijës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Certifikata e asistencës në lindje; Raporti i lehonisë të nënës; Kartela e konsultorit 0-4 vjeç; Kartela e vaksinimit 0-14 vjeç; Kartela mjekësore e neonatit. **Lidhur me pyetjen tuaj, afati kohor per per te bere rregjistrimin e femijes, eshte pa bere femija 1 vjec.** Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 66 | 26.09.2023 | Kërkesë për informacion | 26.09.2023 | Përshëndetje , Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se per te rinovuar pensionin familjar duhet të aplikoni nga llogaria juaj në e-albania shërbimin, Kërkesë për rishqyrtim përfitimi (pensioni) | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | për rishqyrtim pensioni | | në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=2304<br>Do T`ju shfaqen opsionet e mëposhtme. Përzgjidhni opsionin, Familjar<br>Pleqëri<br>Invaliditet<br>Familjar<br>Suplementar Suplementar i parakohshëm Pension i parakohshëm për vjetërsi shërbimi Kompesim i energjisë elektrike (VKM 565, VKM 8) Kompesim për personat në ngarkim. Ngarkoni dokumentet në format pdf dhe dërgoni aplikimin. **Dokumenti që duhet të ngarkoni është dokumenti që vërteton se përfituesi i këtij pensioni nuk është në marrdhënie pune.** Pasi të dërgoni aplikimin, paraqituni në sportelet e Postës Shqiptare për të dërguar dokumentet origjinalë, duke vendosur mbi zarf numrin e referencës së aplikimit. Për çdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit. | | |
| 67 | 26.09.2023 | Kërkesë për informacion për mundësi punësimi | 26.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të parë vendet vakante në Adisa, duhet të vizitoni linkun e mëposhtëm: https://www.adisa.gov.al/mundesi-punesimi/ . Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 68 | 26.09.2023 | Kërkesë për informacion për subvencion fëmije | 26.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se shteti mbështet dhe subvensionon kategoritë e mëposhtme të fëmijëve: 1. të lindurit jashtë martese; 2. personave që nuk kanë gjallë asnjërin nga prindërit; 3. personave të cilëve me vendim të formës së prerë të gjykatës u është hequr e drejta prindërore me vendim gjykate e të dy prindërve ose u është hequr e drejta prindërore për njërin prind dhe prindi tjetër nuk jeton: 4. personave që braktisen nga të dy prindërit dhe nuk u njihet identiteti i tyre. Për rastet e reja të cilat kërkojnë të pajisjen me Librezë Status Jetimi mblidhet Komisioni( një here në 3 muaj), i cili shqyrton dokumentacionin dhe vendos nëse i akordohet ose jo personit përkatës statusi i jetimit. Siç e shihni, fëmijët me prindër të divorcuar nuk janë pjesë e kësaj skeme. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 69 | 26.09.2023 | Kërkesë për informacion për çrregjistrim të personit fizik | 26.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se per te bere cregjistrimin e personit fizik, duhet te aplikoni nga llogaria e biznesit ne e-albania sherbimin , "Aplikim per cregjistrimin e Personit Fizik" në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13893 Lidhur me pyetjen Tuaj, bëjmë me dije se tek mandatpagesa do ngarkoni vërtetimet e gjeneruara nga e-albania lidhur me detyrimet tatimore dhe taksat e tarifat vendore. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 70 | 26.09.2023 | Kërkesë për informacion për mosrespektim të afatit të lëvrimit të shërbimit | 26.09.2023 | Pershendetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion Ju bëjmë me dije se për çdo ankesë lidhur me mosrespektimin e afatit ligjor të lëvrimit të shërbimit, lutemi depozitoni ankesën tuaj në portalin Me ty për Shqipërinë që duam në linkun e mëposhtëm. https://www.shqiperiaqeduam.al/#shtetiNeSHerbim. Për çdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalin e komunikimit (online chat); nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 71 | 26.09.2023 | Kërkesë për informacion për leje ndërtimi | 26.09.2023 | Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion ju bejme me dije se per sherbimin qe kerkoni ju duhet te aplikoni ne sherbimin: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=6093. Per te realizuar kete aplikim, ne ju sugjerojme te orjentoheni prane bashkise ku beni pjese, pasi ata mund t'ju orjentojne lidhur me kete ceshtje. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 72 | 26.09.2023 | Kërkesë për informacion për lëvrim shërbimi | 26.09.2023 | Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju bejme me dije se nese eshte permbushur afati prej 30 ditesh, ju duhet te paraqiteni prane postes ku merrte pensionin nena juaj. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 26.09.2023 | Kërkesë për informacion për vërtetim negativ pozitiv | 26.09.2023 | Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit” neni 10, pika “d” përcakton se: “Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Pershendetje ! Kam aplikuar bashk me bashkeshorten per leshim vertetim negativ pozitiv per te gjith territorin ne portalin e-albania me date 18.09.2023 me date 19.09.2023 kam bere pagesen ne posten shqiptare , por akoma nuk me ka ardhur si pergjigje ne portalin ealbania me posht do ju coj numrin e kerkesen dhe data: Numri kerkeses: 1919. Data e aplikimit: 18.09.2023 Numri kerkeses: 1921 Data e aplikimit: 18.09.2023. Kam me shum se 1 jave qe kam aplikuar dhe nuk me ka ardh asnje pergjigje elektronikisht tek dokumentat e mia ne profilin tim ealbania ? Do ju lutesha te me ktheni nje pergjigje sa me shpejt . Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 73 | 26.09.2023 | Kërkesë për informacion për Përfitimi i pagesës për lejen e barrëlindjes | 26.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të përfituar pagesën e lejes se lindjes, duhet të keni jo më pak se dymbëdhjetë muaj sigurime të paguara, si edhe të jeni në marrdhënie pune në kohën kur u lind e drejta e përfitimit të lejes së lindjes. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 74 | 26.09.2023 | Kërkesë për informacion pr regjistrim ne portalin e-albania | 27.09.2023 | Pershendetje, Ne pergjigje te kerkeses tuaj per informacion, ju bejme me dije se ju duhet te kontaktoni me asistencen e e-albania, ne email e tyre: helpdesk@e-albania.al . Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. | E plotë | Nuk ka |
| 75 | 27.09.2023 | Kërkesë për informacion për Akt Verifikimi | 27.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se hapat e aplikimit të këtij shërbimi janë si më poshtë: Për të plotësuar një AV ose e quajtur ndryshe “Akt Verifikimi” ju duhet të logoheni me të dhënat tuaja në e-Albania dhe më pas të kërkoni | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | shërbimin që ju keni aplikuar së fundmi, shërbim për të cilin do të plotësoni dokumentacionin me AV. Pas kërkimit të shërbimit ju duhet të klikoni **"Përdor"** dhe më pas do të vazhdoni në fund të faqes ku do të gjeni opsionin "Për të dërguar Av të një aplikimi të mëparshëm. Pasi të plotësoni të dhënat e mësipërme, klikoni butonin **"Dërgo".** Ky dokument (AV) është kërkesa ose shkresa juaj që do ia drejtoni ASHK-së. Të dhënat që do të plotësoni në aplikim janë ato që ka cituar ASHK në shkresën ku u kërkon të aplikoni AV0. **Nese nuk arrini ta aplikoni shërbimin, dërgoni me rrugë postare dokumentin qe u kërkon ASHK në shkresën dërguar Juve për të aplikuar AV0, dhe një deklarim me shkrim se nuk po arrini dot të dërgoni aplikimin e kërkuar nga ana e tyre.** Për çdo pyetje apo paqartësi na kontaktoni në kanalin informativ pa pagesë 0800 0118, nga e hëna në të premte në fashën orare 08.00 – 19.00. Faleminderit! | | |
| 76 | 27.09.2023 | Kërkesë për informacion për Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë | 27.09.2023 | Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju bejme me dije se, Ju duhet të aplikoni shërbimin "Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë)" , në linkun: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477 Fillimisht duhet të hartoni një kërkesë me shkrim, ku të sqaroni arsyet e përdorimit të këtij dokumenti. Kjo kërkesë duhet të firmoset nga ana juaj dhe të skanohet n e formatin PDF . Ajo do të ngarkohet në hapin e tretë të formularit në e-Albania. Pergjigjen e merrni tek opsioni Dokumentat e Mia ,ne llogarine e-albania. Afati per marrjen e sherbimit eshte Per 10-21 dite pune. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. | E plotë | Nuk ka |
| 77 | 27.09.2023 | Kërkesë për informacion për ndryshim në të dhënat e personit fizik | 28.09.2023 | Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju mund ti drejtoheni drejtperdrejte Qendres Kombetare te Biznesit ne adresen info.qkb@qkb.gov.al , pasi ky eshte institucioni qe mund te ekzekutoj veprimin qe ju kerkoni. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 78 | 28.09.2023 | Kërkesë për informacion për Ndryshime në të dhënat e regjistrimit të personit fizik | 28.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se shërbimi elektronik për ndryshim të regjistrimit të Personit Fizik u ofrohet subjekteve që kanë një llogari në portal. Për të kryer aplikimin për ndryshim të regjistrimit të Personit Fizik, subjekti aplikon duke plotësuar formularin përkatës për ndryshim të regjistrimit të Personit Fizik. Mbështetur në nenin 43 të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar, çdo subjekt, që kryen regjistrimin fillestar, mbart edhe detyrimin të regjistrojë çdo ndryshim në të dhënat e njoftuara dhe në dokumentet shoqëruese, që depozitohen në regjistër, sipas seksionit III të këtij ligji.**Dokumentacioni i nevojshëm** *Dokumentet që duhet të ngarkohen nga aplikanti:* Akti i përfaqësimit prane noterit nëse aplikanti nuk është personi përgjegjës për aplikim<br>**Hapat e procedures** Identifikohuni si biznes në portal,Zgjidhni shërbimin "Aplikim për ndryshim të regjistrimit të Personit Fizik",Klikoni butonin "Përdor", Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme mbi subjektin, Klikoni butonin "Dërgo" në faqen e fundit të formularit, Punonjësi i QKB-së proceson kërkesën e ardhur dhe në varësi të vendimit që merret i kthen përgjigje me e-mail aplikuesit, me URL-në e shkarkimit të përgjigjes elektronike të ruajtur tek "Dokumentet e mia" në e-Albania, ose me njoftimin e arsyes së refuzimit. Për më shumë informacion dërgoni email në, info.qkb@qkb.gov.al Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 79 | 28.09.2023 | Kërkesë për informacion për Aplikim për regjistrim të aktit të trashëgimisë | 28.09.2023 | Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se fillimisht duhet të bëni pranë një noteri çeljen e trashëgimisë. Më pas, me cilësinë e trashëgimtarit ligjor, nëse prona është e çertifikuar, bëni regjistrimin e dëshmisë së trashëgimisë **përmes platformës qeveritare e-Albania në linkun:** https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9467 duke kërkuar shërbimin " Aplikim për regjistrim të aktit të trashëgimisë" Aplikoni duke plotësuar formularin elektronik që shfaqet në platformë duke ngarkuar dokumentacionin e nevojshëm për lëvrimin e | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | shërbimit. Në hapin e dytë duhet të shtoni edhe këto shërbime: L1-Lëshim certifikate pronësie. I5- Lëshim kopje kartele te pasurisë I4-Lëshim kopje te fragmentit te hartës kadastrale. Nëse prona nuk është e certifikuar, pra nuk zotëroni një certifikatë pronësie në emër të gjyshit, për të marrë informacion për çështjen që referoni në kërkesën për informacion, aplikoni nga llogaria e njërit prej trashëgimtarëve nëe-albania shërbimin:Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë), ne linkun e meposhtem: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477. Procedura duhet te shoqërohet me një kërkesë me shkrim nga ana Juaj në format PDF, të cilën do ta ngarkoni në hapin e tretë të aplikimit. Agjencia Shtetërore e Kadastrës do T`Ju pajisë me informacionin që kërkoni. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit! | | |
| 80 | 28.09.2023 | Kërkesë për informacion për kërkesë e paqartë për informacion | 28.09.2023 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se në këtë kanal komunikimi informojmë lidhur me procedurën e aplikimit të shërbimeve publike në portalin e-albania. Kërkesa Juaj është për Air Albania. Për këtë kërkoni informacion në faqen zyrtare të air albania. https://www.airalbania.com.al/. Nëse jeni shprehur gabimisht dhe kërkoni të dini se në cilin opsion u mbërrijnë dokumentet për të cilat keni aplikuar në e-albania, informojmë se dokumentet i gjeni në seksionin " Dokumentet e mia" në llogarinë Tuaj në e-albania. Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00.Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 81 | 28.09.2023 | Kërkesë për informacion për mandat pagese për licencë profesionale | 29.09.2023 | Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju bejme me dije se per rastin tuaj lutemi na kontaktoni ne faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al/ ne live chat, ne menyre qe te mund t'ju ndihmojme per problematiken tuaj. | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 82 | 28.09.2023 | Kërkesë për informacion për shpallje martese | 29.09.2023 | Pershendetje, Ne vijim te kerkeses tuaj per informacion, ju bejme me dije se, Shpallja e martesës pa qenë i/e pranishëm kryhet me prokurë të posacme . Procedura për të bërë shpalljen e martesës është si më poshtë vijon: Në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj, nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet e mëposhtme për shpalljen e martesës (të legalizuar, përkthyer dhe noterizuar): Certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e Gjendjes Civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile; Dokumentin / Certifikatë që vërteton se nuk ka pengesëligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese); Dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj; Fotokopje e dokumentit të identifikimit. Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar. Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm: Certifikatë lindje; Certifikatë lindje me shënimin "për lidhje martese". Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare. Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikatë martese /ekstrakt akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e Gjendjes Civile në Shqipëri, në zyrën e Gjendjes Civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Per pyetje te metejshme lutemi na kontaktoni ne faqen tone zyrtare ne live chat, https://www.adisa.gov.al/ . | E plotë | Nuk ka |
| 83 | 28.09.2023 | Kërkesë për informacion për njehsim | 29.09.2023 | Përshëndetje, Në zbatim të ligjit nr. 119, datë 18.09.2014 "Për të drejtën e informimit" neni 10, pika "d" përcakton se: "Koordinatori i të drejtës së informimit të një autoriteti publik, dërgon kërkesën për informim te një | E deleguar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | diplome nga IAL | | autoritet tjetër publik, Brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezulton se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa nuk e zotëron informacionin e kërkuar”. Përshendetje! Shtetase greke ka dorëzuar me poste dokumentet e nevojshme per te bere njohjen e diplomes se saj dhe ka plotësuar edhe kërkesën elektronike ne platformën e E-albania. I është kërkuar të ngarkojë elektronikisht ne format pdf gjithë dokumentacionin. Theksoj qe nuk ka kartë identiteti shqiptare dhe si e tillë nuk di se si mund ti ngarkojë keto dokumente ne mënyrë elektronike. Do ju ishte mirënjohëse nëse i dergoni nje link ku te lehtesonit disi kete hap qe te ndjeki procesin e njohjes. Nese dëshironi mund ta nisni dhe në këtë adresë e-maili linkun perkates qe te kem mundësi ta ndihmoj. Flas ne emer te saj thjesht per ta ndihmuar meqenëse eshte e huaj. Ju falenderoj! | | |
| 84 | 29.09.2023 | Kërkesë për informacion për vërtetim për individ të parregjistruar | 29.09.2023 | Përshëndetje, Lutemi na kontaktoni në faqen tonë zyrtare në live chat https://www.adisa.gov.al/ , që të mund të kuptojmë më tej problematikën tuaj dhe të mund t’ju ndihmojmë. | E plotë | Nuk ka |